



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)
Periudha raportuese	Raporti muJOR, shkurt 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi dhe Valbona Gashi

#### 1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes / ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

##### Kulturë:

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga Drejtoria dhe Komuna.
- Përgatitja e raportit të punës për DKRS – Sektori i kulturës dhe gjinisë, Biblioteka, Arkivi, teatri “Dodona” dhe QKF-ja.
  - Janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e ambasadave, gjegjësisht me përgjegjësit kulturorë që veprojnë në Komunë të Prishtinës.
  - Në kalendarin kulturor, në vazhdimësi regjistrohen aktivitetet e organizuara nga Komuna e Prishtinës dhe aktivitete për të cilat njoftohemi përmes shkresave dhe njoftimeve në media.
  - Është bërë përgatitja e materialit për tenderë, pjesa teknike, për vitin 2016.
  - Sa i përket çështjes gjinore, mbarëvajtja e përgjithshme e punës është realizuar me sukses, si takimet me palë, bashkëpunimi/konsultimet me organizata vendore dhe ndërkombëtare relevante, organizimi i takimeve, pjesëmarrjet, planifikimi për aktivitete etj.
  - Muaji shkurt i vitit 2016, pati vështirësi dhe pengesa sa i përket realizimit të punëve profesionale dhe detyrave që ka Biblioteka.
  - Pati shumë ankesa nga lexuesit e sallave të leximit për titujt e rinj, e që kanë mbetur në paketa, dhe për mungesë të vendeve në sallat e leximit.
  - Planifikimi i shërbimeve dhe aktiviteteve të bibliotekës varet nga fillimi i punës në objektin e ri, i cili mjerisht ende nuk është gati.
  - Në teatrin “Dodona”, gjatë muajit shkurt janë zhvilluar një sërë aktivitete për realizimin e shfaqjeve të programit të rregullt, si dhe aktivitete përgatitore për realizimin e premierave të reja.

- Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, ka realizuar koncertin me rastin e Festës së Pavarësisë, më 17 shkurt 2016, në teatrin “Dodona”.
- Është realizuar me sukses turniri i ping-pongut, në bashkëpunim me kolegjin ISP.
- Janë mbajtur orët e rregullta në të gjitha seksionet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin e Valleve në Turqi.

#### **Rini dhe Sport:**

- Pas grumbullimit të informatave të klubeve sportive të kryeqytetit, përmes formuluarve të sportit komunal, gjatë muajit shkurt është bërë përpunimi i të dhënave, ku kemi arritur të krijojmë një listë të re të klubeve publike, pasi që qëllimi i plotësimit të këtij formulari nga ana e tyre, ka qenë që të njihemi me gjendjen aktuale të klubeve, në mënyrë që Sektori ynë të bëjë një selektim të klubeve sportive publike të përgjegjshme dhe të atyre të papërgjegjshme apo jo aktive.
- Gjatë muajve janar dhe shkurt, janë evidentuar klubet sportive dhe OJQ-të rinore lidhur me mbylljen e raporteve narrative dhe financiare për projektet e përkrahura gjatë vitit 2015.
- Pasi që gjatë muajit janar nuk ka kaluar projekti kapital “Pajisja e klubeve sportive të komunës së Prishtinës me rekuizita sportive”, për loton I dhe IV, gjatë muajit shkurt kemi diskutuar që këto dy loto, pra I dhe IV, të rishqyrtohen, pasi që është e pamundur të zgjidhen operatorë ekonomikë që mund të bëjnë sigurimin e disa pajisjeve më specifike, siç janë të përshkruara në loton IV (rekuizita për sportin e shigjetarisë, shenjëtarisë, peshëngritjes, bjeshkatarisë etj.). Për të mos iu mbetur borxh klubeve të këtyre sporteve të cekura më lart, DKRS ka menduar që këto pajisje do të ju sigurohen në forma të tjera.
- Gjatë muajit shkurt, është bërë hapja e ofertave për projektin “Ndërtimi i këndeve të lodrave për fëmijë në lagjet “Kalabria” dhe “Kodra e Diellit”, ndërsa në fund të këtij muaji ka filluar vlerësimi i këtij tenderi nga Komisioni i caktuar për vlerësim, të cilët ende nuk kanë dalë me një vendim final mbi zgjedhjen e OE-së së përgjegjshëm dhe e cila pritet të bëhet në fillim të muajit mars 2016.
- Në muajin shkurt, kemi pranuar kërkesë për regjistrim prej tri klubeve sportive, të cilët pas kompletimit të dokumenteve nga ana e tyre, bazuar në kriteret mbi regjistrimin e klubeve publike sportive, janë licencuar klubi i atletikës “Gërmia”, Klubi i Sporteve të Ujit “Zenit Aquatic Club”, si dhe shoqata bjeshkatore alpiniste “Shkëmbi”.

#### **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

## Kulturë:

- **Arkivi i qytetit**
  - Është realizuar një vizitë pune në Arkivin e Perandorisë Osmane në Stamboll, Turqi nga ana e Abaz Makollit. Kjo vizitë ka qenë e organizuar nga Universiteti i Prishtinës dhe Ambasada e Turqisë në Prishtinë.
- **Biblioteka**
  - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
  - Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
  - Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
  - Huazimi i librit dhe lidhja e gazetave;
  - Leximi dhe komentimi i librit;
  - Vizatime nga përmbajtja e librit;
  - Lojëra logjike, punë dore etj.;
  - Krijimi i faqes së bibliotekës në Facebook;
  - Përgatitja e raporteve vjetore për vitin 2015 dhe raporteve mujore.
- **Teatri “Dodona”:**
  - Planifikohen dy shfaqje premierë: “Fustani pika-pika”, për fëmijë, dhe “Më fol për dashurinë”, për të rritur;
  - Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave dhe atë të mbrëmjes;
  - Reprizë e shfaqjes “Libri shumëgjyresh”, me rastin e Ditës;
  - Shfaqje të organizuar nga trupa mysafire: dy repriza të shfaqjes “Gjyshi im është kuller” (Skënderaj); 1 program rasti (Qendra e Fëmijëve Prishtinë) me rastin e Ditës së Pavarësisë, më 17 shkurt 2016;
  - 1 audicion për programin “Gjeniu i vogël”;
  - Provat e përditshme për premierat e reja.

## QKF

- Koncert, më 17 shkurt 2016;
- Turnir i ping-pongut;
- Inicimi, planifikimi dhe organizimi i “Debatit me karakter garues”, në bashkëpunim me “Save the Children”, me rastin e 7 Marsit;
- Planifikimi dhe organizimi, në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit, lidhur me aktivitetin e programit festiv lidhur me 7- 8 Marsin.

## Rini dhe Sport

- 21 Marsi – Dita e Pranverës;

- Prezantimi i Projektlanit të veprimit rinor lokal 2016-2018 në Bordin e Drejtorëve, respektivisht në Kuvendin e Komunës, me qëllim të miratimit të këtij plani;
- Thirrja për Aplikim për subvencionim vjetor të klubeve sportive;
- Shqyrtimi i projekteve rinore dhe sportive për fazën e parë të subvencionimit.

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

**Kulturë:**

- Fillimi i trajnimeve të fëmijëve të Asamblesë komunale të Prishtinës, ambasadorëve nga Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, si dhe grupit “ROR”, lidhur me rregullat dhe teknikat e debutuesve për aktivitetin “Debat me karakter garues”.
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit dhe lidhja e gazetave;
- Leximi dhe komentimi i librit, vizatime nga përmbajtja e librit, lojëra logjike, punë dore etj.;
- Publikimi i materialeve në faqen e bibliotekës në Facebook;
- Përgatitja e raportit vjetor për vitin 2015, dhe raporteve mujore;
- **Bashkëpunimi me Këndin Amerikan** - Biblioteka Përkujtimore ka filluar edhe këtë vit bashkëpunimin me Këndin Amerikan, me qëllim të edukimit joformal, ligjërata në gjuhën angleze dhe nga fusha të tjera, si: teknologjia informative, ekonomia, dizajni etj.;
- **Vizita nga fëmijët e SOS - Kopshtit** - Në muajin shkurt kanë qenë dy vizita nga fëmijët e SOS - Kopshtit të Prishtinës. Fëmijët e moshës 4-5 vjeçare, gjatë kësaj vizite janë informuar për aktivitetet të cilat realizohen në Bibliotekën Përkujtimore, lexuan tregime, realizuan punëtorinë për të krijuar librin e tyre me ndihmën e bibliotekares dhe edukatoreve të SOS - Kopshtit.
- **Festa e Pavarësisë së Kosovës.**
- Biblioteka “Hivzi Sulejmani” me këngë, valle e poezi, festoi përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës në lokalet e degës Përkujtimore. Programin e kanë përgatitur punëtorët e kësaj dege, bashkë me lexuesit e bibliotekës.
- **Dita Botërore e Leximit me Zë** - është shënuar më 24.2.2016, në lokalet e Këndit Amerikan. Në këtë aktivitet kane marrë pjesë nxënësit, anëtarë të Bibliotekës

Përkujtimore, ku u organizuan punë me grupe, lexuan me zë tregime dhe krijuan postera për këtë ditë.

- **Kurs për mësimin e shkrim-leximit për gratë e paarsimuara** të lagjeve “Kodra e Trimave” dhe “Mati”, në bashkëpunim me SOS - Fshatrat e fëmijëve të Kosovës, Këndit Amerikane dhe Biblioteka Përkujtimore - pjesë e programit “Fuqizimi i Familjes”.

#### **Teatri Dodona:**

- Sipas planit dhe dinamikës së caktuar, kanë vazhduar provat e dy premierave të teatrit “Dodona”, një për skenën për fëmijë dhe një për të rritur.
- Realizimi është bërë sipas planit. Janë realizuar dy premiera: “Fustani pika-pika” për fëmijë, më e shikuara, nga 1007 shikues, dhe “Më fol për dashurinë” - skena për të rritur, e shikuar nga 188 shikues.
- Po kështu në periudhën raportuese, shkurt 2016, janë realizuar 24 repriza të shfaqjeve nga repertori i Teatrit të Kukullave, me gjithsej 1790 shikues, dhe 4 programe mysafire, në bashkëpunim me partnerë. Shfaqjet janë realizuar si më poshtë:
- “Fustani pika -pika” - 9 repriza, “Princi i vogël” - 2 repriza, “Libri shumëgjyresh” - 1 reprizë, “Kësulëkuja” - 2 repriza, “Rosak pastërtori” -1 reprizë, “Topi - hopi” 2 repriza.
- Janë realizuar - 7 repriza të shfaqjeve për të rritur: “Më fol për dashurinë” - 3 repriza, “#2015” - 2 repriza, “Lojë martese” - 1 reprizë.
- Në muajin shkurt janë realizuar 2 repriza të shfaqjes “Gjyshi im është kuller” e trupës teatrore nga Klina, me çka vërtetohet se TQP “Dodona” u jep hapësirë edhe trupave të reja për promovimin e punës artistike.
- Gjithashtu janë zhvilluar edhe dy ( 2) aktivitete për nder të Ditës së Pavarësisë, në bashkëpunim me Qendrën e Fëmijëve - Prishtinë dhe kolegjin “Universum”.
- Në kuadër të aktiviteteve dytësore, janë mbajtur 2 provime të Akademisë së Arteve të Bukura.
- TQP “Dodona” ka zhvilluar edhe aktivitete shtese. Është zhvilluar audicioni për sezonin 2016, i aktivitetit kulturor mbarëkombëtar “Gjeniu i vogël”.

#### **QKF**

- 15 shkurt 2016, Turniri i ping-pongut, në bashkëpunim me kolegjin ISP. Janë ndarë mirënjohje për të gjithë fëmijët pjesëmarrës dhe medalje për vendet e para. Pas përfundimit të Turnirit, kolegji ISP ka shtruar drekë për të gjithë pjesëmarrësit.

17 shkurt 2016 – Koncert i QKF në teatrin “Dodona” – Kori, ambasadorët e rinj dhe grupi i valltarëve me potpuri vallesh me motive të trevave shqiptare.

## Rini dhe Sport

- Pjesëmarrje në seminarin lansues të organizuar nga organizata “Sport4All”, në bashkëpunim me MKRS, e cila është mbajtur më 11 shkurt 2016. Qëllimi i këtij seminari ishte:
  - Mbledhja e të gjitha palëve të interesuara në fushën e sportit në Kosovë, duke përfshirë MKRS-në, komunitatet, federatat dhe klubet sportive, si dhe OJQ-të që punojnë për persona me nevoja të veçanta, bashkësive dhe risocializimin ose barazinë gjinore;
  - Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përfshirjes së personave me nevoja të veçanta, komunitetet pakicë, popullatat e izoluara, të marginalizuara, rurale, të papunë, si dhe gratë dhe vajzat (si një temë e tërthortë) për të ndërtuar një shoqëri më të mirë në Kosovë.
- Thirrja për propozim për vitin 2016, ku buxheti i ndarë për këtë thirrje ishte në vlerë prej 32,000 €. Të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat e ndryshme sportive rinore që prekin kategoritë e lartpërmendura.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

## Kulturë

- Disa nga aktivitetet e Bibliotekës, të përmendura më sipër, janë të përhershme dhe realizohen gjatë gjithë vitit.
- Gjatë gjithë periudhës raportuese, janë realizuar provat e rregullta për shfaqjet e reja: “Fustani Pika-Pika” për Teatrin e Kukullave si dhe “Më fol për dashurinë”, për skenën për të rritur.  
QKF ja.
- Përgatitjet për shënimin e festave të 7 dhe 8 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas. Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin ndërkombëtar të valleve në Turqi.

## Rini dhe Sport

- Prezantimi i Projektplanit të veprimit rinor lokal 2016-2018 në Këshillin e Drejtorëve, respektivisht në Kuvendin e Komunës, me qëllim të miratimit të këtij plani.

#### **4.1.2. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese.**

##### **Rini dhe Sport**

- Për vitin 2016 për Sektorin e Rinisë dhe Sportit, janë ndarë 250,000 €, ku prej tyre 150,000 € janë planifikuar të shpenzohen për aktivitetet vjetore të klubeve sportive, 50,000 € për projekte të ndryshme sportive, si dhe 50,000 € për subvencione të projekteve rinore.

#### **4.1.3 Takimet me palë**

- Zyra e Sektorit të kulturës kishte vërshim të palëve, të cilët, shpesh të pa paralajmëruar, paraqiteshin në zyrë për të marrë ndonjë informacion rreth kërkesave për subvencionim. Po ashtu, palët lajmëroheshin përmes e mailit dhe përmes telefonit për pyetje të njëjta.
- Takim me Shoqatën e të Shurdhërve, rreth informimit për kërkesën për subvencionim.
- Takime të vazhdueshme me palë, përfitues të subvencioneve, rreth raporteve narrative dhe financiare.
- Takime me institucionet vartëse të DKRS-së lidhur me planifikim e organizimit të 7 dhe 8 Marsit.
- Takime me disa prindër të interesuar për të regjistruar fëmijët në QKF.
- Takime me zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës.
- Takime të vazhdueshme rreth informacioneve për subvencione, raporte, si dhe konsultime për çështje gjinore, si dhe informacione bazuar në nevoja të drejtorisë.
- Takim me Refik Gërbeshin, lidhur me 7 Marsin, kërkoi që shfaqja teatrale të inkorporohet në programin e Komunës.
- Takim me OJQ "Dita", lidhur me mundësitë e bashkëpunimit për vitin 2016.

##### **Rini dhe Sport**

- Takime me përfaqësues të klubeve sportive të kryeqytetit, për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën e sportit dhe kërkesa për mënyrën e aplikimit.
- Takime me përfaqësues të OJQ-ve rinore, të cilat u informuan për mënyrën e ndarjes së fondeve gjatë vitit 2016, dhe për mbylljen e raporteve të projekteve të subvencionuara gjatë viteve 2014 - 2015.
- Sektori i rinisë dhe sportit mbështet dhe përkrah çdo iniciativë të të rinjve të kryeqytetit, duke u bazuar gjithnjë në politikat programore të sektorit, si dhe në mundësitë buxhetore që posedon ky sektor.

## 5. Takimet me institucione të tjera

### Kulturë

- Inicim dhe takim me ambasadat në DKRS.

U organizua takimi me ambasada, gjegjësisht përgjegjësit për kulturë: British Council, British Embassy, Swiss Embassy, Bulgarian Embassy, German Embassy, Embassy of Sueden, Austrian Embassy, Embassy of Luxemburg, Belgian Embassy, Italian Embassy, French Embassy dhe Culture for All.

Në këtë takim u fol për shkëmbimin kulturor, bashkëpunimin që mund t'i ofrojnë ambasadat Komunës së Prishtinës, me theks të veçantë Festa e Muzikës, për të sjellë grupe muzikore, këngëtarë.

Koordinimi dhe bashkëpunimi i aktiviteteve kulturore të ambasadave dhe Komunës, si dhe njoftimi i aktiviteteve që organizojnë ambasadat, në mënyrë që t'i njoftojmë qytetarët e Prishtinës për ngjarje që organizohen në kryeqytet.

- Biseda me "Korin Gazmor", i cili e ndihmon teatrin "Dodona" në shumë raste, në aktivitete teatrore, për organizimin e një koncerti rasti gjatë shënimit të ditëve të Betejës së Prekazit, më 5 mars 2016.

### Rini dhe Sport

- Takim i radhës organizuar nga Departamenti i Rinisë i MKRS-së. Në këtë takim u diskutua për zbatimin e Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, nr. 03/L-145, si dhe niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërjen e komunës, si dhe prezantim i Projektplanit të veprimit për rininë 2016-2017. Në këtë takim prezantuam punën e Sektorit të rinisë të Komunës së Prishtinës, i njoftuam të pranishmit me ecurinë e punës rreth Planit të veprimit rinor lokal 2016 -2018, si dhe aktivitetet tjera të punës me të rinjtë.



- Takim me Xhevat Bajramin, drejtor i Departamentit të Rinisë në MKRS. Në këtë takim u diskutua për mundësinë e ndërtimit të një Qendre Rinore në komunën e Prishtinës, dhe u pajtuam për bashkëpunim edhe me të ngushtë në të ardhmen.

## 6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

### *Rini dhe Sport*

- Pas takimeve me disa përfaqësues të OJQ-ve, të njëjtit janë njoftuar se me hartimin e Planit të veprimit rinor lokal, do të bëhet thirrja publike për aplikim me projekte rinore. Ata u njoftuan se përzgjedhja e projekteve do të bëhet në bazë të kriterëve që do të caktohen nga DKRS-ja.

#### 6.1.1 *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

#### 6.1.2 *Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër.*

- Sektori i kulturës është ende në pritje të listës përfundimtare për njoftimin e palëve rreth kërkesave të miratuara dhe refuzuara nga komisioni vlerësues, të fazës së fundit.
- Në muajin shkurt, për subvencionim janë pranuar dhe regjistruar gjithsej 16 kërkesa të reja.
- Pranimi i raporteve të lëndëve të subvencionuara të fazave paraprake.

### **Rini dhe Sport**

- Në këtë sektor, gjatë muajit shkurt janë pranuar gjithsej 26 lëndë, ku 25 kërkesa janë nga klubet dhe shoqatat sportive, ndërsa 1 është nga OJQ-të rinore.

## 7. Takime të tjera

- Pjesëmarrje në ligjëratën e organizuar nga EUICC- zyra në Prishtinë, me përfaqësueset nga DKRS-ja, znj. Drita Rudi dhe znj. Mevlude Zejnullahu;
  - Pjesëmarrje e përfaqësueses nga DKRS ja, znj. Drita Rudi, në ligjëratën e organizuar nga EUICC- zyra në Prishtinë. U bë prezantimi i gjetjeve nga hulumtimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve për shtetin social.
  - Pjesëmarrje në punëtorinë njëditore, të organizuar nga OSCE, me temën "Punëtorja fillestare për konsultim me komunitete". Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në bashkëpunim me Universitetin e Northamptonit, Mbretëria e Bashkuar, pjesëmarrëse, të ftuara nga DKRS-ja ishin znj. Drita Rudi dhe znj. Mevlude Zejnullahu.
- Takime të rregullta pune në kuadër të aktiviteteve të shumta të Teatrit Dodona.

Commented [DR1]:

Commented [DR2]:

## 8. STATISTIKAT

Edhe në muajin shkurt ka pasur interesim të madh për anëtarësime të reja në bibliotekë, për huazim të librit dhe për përdorimin e sallave të leximit, si në qendër, ashtu edhe në të gjitha degët e bibliotekës.

Prej 100-200 në ditë, sillet numri i atyre që e vizitojnë bibliotekën

## 9. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për subvencionim, ka shkaktuar shumë pakënaqësi të palët, duke shtuar fluksin e vizitave në zyrën e Sektorit të kulturës, e që shpesh ndikonte në ndërprerjen e procesit të punës.
- Sfida më e madhe që po na përcjellë me vite dhe po ndikon në realizimin e objektivave tona, është hapësira e pamjaftueshme për vendosjen e librave të reja, të cilat do të shfrytëzoheshin nga lexuesit, mungesa e hapësirës në salla të leximit për studentë, mungesa e hapësirës për shërbime të reja inovative në bibliotekë, ku do të inkuadrohej komuniteti dhe do të rritej interesimi për librin dhe leximin, dhe biblioteka do të ishte qendër kulturore e komunitetit për mësim gjatë gjithë jetës.
- Sfidat në teatrin "Dodona" janë të shumta, sepse kemi nevojë për mjete, që ta shtojmë prodhimin me shfaqje të reja, rikthimin e shfaqjeve të vjetra të suksesshme, si dhe mbështetjen e udhëtimeve që

shfaqjet tona që kanë vlerë, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur, të jepen jo vetëm jashtë Prishtine, por edhe jashtë Kosovës.

## **Rini dhe Sport**

- Ky sektori vazhdimisht ka hasur në vështirësi gjatë kryerjes së lëndëve/projekteve të subvencionuara gjatë procedurave për pagesa, konkretisht në zyrën e financave.  
Edhe gjatë këtij muaji kemi hasur në vështirësi në kryerjen e pagesës së anëtarëve të komisionit, të cilët kanë qenë caktuar për zgjedhjen e sportistit të vitit 2015, e cila ende nuk ka arritur të realizohet.

**10. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

**11.**

- Mungesë e stafit në DKRS, e ne veçanti e një punëtori administrativo-teknik dhe financier.
- Teatri "Dodona", Arkivi, Biblioteka dhe QKF-ja, i kanë dorëzuar në vitin 2014, e po ashtu edhe në janar të këtij viti, kërkesat për pajisje dhe materiale.
- Rekomandojmë që të lejohen mjetet për realizimin e vizitës së Arkivit Krahinor të Mariborit, i cili çdo vit në muajin prill, organizon takime shkencore dhe profesionale me arkivat në rajon, me temën "Problemet teknike në rregullimin e lëndës arkivore, në mënyrë klasike dhe elektronike". Në këtë trajnim ligjërojnë ekspertë të arkivistikës, sipas standardeve të BE-së.
- Angazhim maksimal për fillimin e punës në objektin e ri të Bibliotekës.
- Trajnime të stafit të bibliotekës për organizimin e fondit dhe hapësirave në objektin e ri dhe njohuri për shërbime të reja.

**12. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

- Realizimi i aktiviteteve të planifikuara lidhur me 7-8 Marsin;
- **7 Marsi - Dita e Mësuesit në Biblioteka Përkujtimore;**
- Përmirësimi e dizajnit të ueb-faqes së Bibliotekës  
<http://www.biblioteka-pr.org/>
- Aktivitete çdo javë në bashkëpunim me Këndin Amerikan, në degën “Përkujtimore”;
- Aktivitete me fëmijë: komentim i librit, vizatime, punë dore në degën “Përrallat”;
- Vazhdimi i takimeve me institucionet dhe organizatat lidhur me organizimin e 7 dhe 8 Marsit;
- Gjatë muajit mars 2016, planifikohen të realizohen disa aktivitete.

Teatri i Kukullave.

- “Fustani pika-pika” - 2 repriza; “Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët” - 2 repriza; “Tomi e Xheri” - 2 repriza; “Cirku i lodrave” - 2 repriza;
  - Dita Botërore e Teatrove të Kukullave - shfaqje për fëmijë;
  - Shfaqje të rregullta nga skena e mbrëmjes;
  - Për nder të Ditës Botërore të Teatrit (27 mars), planifikohet të jepet shfaqja “#2015”;
  - Shfaqjen e një koncerti me rastin e 5 Marsit, Ditët e Prekazit, me “Korin Gazmor”;
  - Provat e rregullta të shfaqjeve të repertorit, me qëllim të ruajtjes së nivelit artistik dhe teknik të shfaqjeve;
  - Planifikohet një koncert me Grupin e Baletit të Rudina Bëdynajt;
  - Planifikohet edhe një provim i Akademisë së Arteve Dramatike (mars 2016);
  - Planifikohen biseda dhe takime për aranzhimin e realizimit të një turneu disaditësh në Tiranë, për realizimin e tri shfaqjeve të skenës së mbrëmjes në formë shkëmbimi kulturor.
- QKF
- Përgatitjet për shënimin e festave të 7 dhe 8 Marsit- Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Gruas;
  - Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Valleve në Turqi. Përgatitjet e ambasadorëve të rinj për debate.

## Rini dhe Sport

- Pjesëmarrje në punëtorinë me temën: “Punëtorja fillestare për konsultim me komunitete”, e organizuara nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në bashkëpunim me Universitetin e Northamptonit, Mbretëria e Bashkuar, e cila do të mbahet më 3 mars 2016 në hotel “Sirius”.

**13. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**

Gjatë muajit shkurt janë realizuar 29 programe në teatrin “Dodona”, që është dëshmi e angazhimeve të shumta të teatrit.